



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE SHQIPTARE, PJSËTARE E KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për pranimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Shkodër, Lezhë, Elbasan, Korçë, Kamëz, Fier, Tiranë, Durrës të paraqitura nga Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, me vendimin e KQZ-së nr. 228, datë 27.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 7.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe Partia Aleanca Demokratike Shqiptare. KQZ, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkive:



**Nr. 632 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Aleanca Demokratike Shqiptare", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

- Elbasan me vendimin nr. 501 datë 17.05.2019.
- Durrës me vendimin nr. 503 datë 17.05.2019.
- Shkodër me vendimin nr. 502 datë 17.05.2019.
- Kamëz me vendimin nr. 530 datë 18.05.2019.

Brenda afatit Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, nuk ka plotësuar dokumentacionin sipas vendimeve të KQZ-së vetëm për Bashkinë Kamëz dhe Elbasan. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare nuk ka depozituar në KQZ formularë e vetëdeklarimit për Këshillin e Bashkisë Kamëz dhe Elbasan. Referuar nenit 5, pika 2, parashikohet se, "Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit". Në këto kushte KQZ referuar nenit 73, pika 2, duhet të refuzojë listat e kandidatëve për Këshillin Bashkisë Kamëz dhe Elbasan të Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkive: Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Tiranë, Durrës; pasi bashkitë Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Tiranë, Durrës, administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Tiranë, Durrës. Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetarë apo për këshillin e bashkive: Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Tiranë, Durrës; pasi bashkitë Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Tiranë, Durrës administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Tiranë, Durrës Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtarë këshilli në Këshillin e Bashkive: Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Tiranë, Durrës, të propozuar nga Partia Aleanca Demokratike Shqiptare;
2. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
3. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
4. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
5. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
6. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Tiranë, Durrës të Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezulton se:

### **Lista shumemërore e Bashkisë Shkodër:**

Kandidati me numër **rendor 7, z. Arbër Ludovik Balaj** në bazë të vendimit nr. 606 dt.13.06.2016 të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është deklaruar fajtor për veprën penale të " Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt" parashikuar nga neni 291 i K.Penal është denuar me 12 ditë burgim.

Në aplikim të nenit 406 të K.Pr. Penale është dënuar përfundimisht me 8 ditë burgim.

Gjykata e Apelit Shkoder me vendimin nr. 170 datë 15.03.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm, me këtë ndryshim:

-Dënimin e të pandehurit me 3 muaj burgim.

-Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale është dënuar përfundimisht me 2 muaj burgim.

Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim të pavuajtur, për një periudhë kohe prej 18 muaj.

Rehabilituar në bazë të nenit 69 K.Penal.

Zyra e gjendjes gjyqësore nuk ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, Bashkia Lezhë dhe Fier. KQZ do të vazhdojë e procedurat të mëtejshme për verifikim.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Shkodër, Lezhë, Korçë, Fier, Tiranë, Durrës të Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Refuzimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Kamëz dhe Elbasan të Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor



2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 632 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Aleanca Demokratike Shqiptare", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019